

Njoftim për orën dhe vendin e provimit për AL datë 08 Korrik 2023!

Njoftohen të gjithë kandidatët për Auditues Ligjor që do të marrin pjesë në provimin e datës 08 Korrik 2023 *“Qeverisja e shoqërive tregtare dhe zbatimi në praktikë i kërkesave të etikës profesionale dhe të biznesit”*, se provimi do të zhvillohet në ambientet e Fakultetit të Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës me adresë në Bulevardin Gjergj Fishta 52, Tiranë.

Provimi do të zhvillohet nga ora 12:00 deri në orën 15:00.

Tarifa e provimit do të kryhet në llogarinë bankare me detajet e mëposhtme:

Banka: BKT

Emërtimi: Bordi i Mbikëqyrjes Publike

Nr. i llogarisë: 434003100

IBAN: AL4520511344003100CLOTCLALLI

Përshkrimi: Tarifë për provimin për AL [Emërtimi i provimit]

Tarifa e provimit VI: 30,000 lekë

Afati i fundit i pranimit të pagesave dhe dorëzimit të mandatit të pagesës për këtë provim do të jetë data 06 Korrik 2023, ora 15:00.

Ju lutemi të dorëzoni një kopje elektronike të skanuar të dokumentit bankar që vërteton kryerjen e pagesës pranë Sekretarisë Teknike të KPAP-së & Strukturës Mbështetëse të Bordit të Mbikëqyrjes Publike brenda afatit të sipërcituar. (sekretaria.teknike.kpap@ieka.al & info@bmp.al)

Kandidatët duhet të kenë me vete ditën e provimit një dokument identifikimi (pasaportë ose kartë ID), makinë llogaritëse si dhe mandatin që vërteton kryerjen e pagesës së provimit dhe duhet të paraqiten së paku 1 orë përpara fillimit të provimit.

Ju urojmë suksese!